



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe nenit 40.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008), dhe dispozitave të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës ,Nr.27/2008), në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, sipas Instruksionit për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2016 të Ministrisë së Financave nenit 5 dhe 55.1, të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 569/1 i datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 24 maj 2016 merr këtë:

VENDIM

Për rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2016

Neni 1

Komuna e Rahovecit konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe sipas Instruksionit për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2016 të Ministrisë së Financave, miraton propozimin e Kryetarit të Komunës Nr. 229 i datës 19.05.2016, për Rishikimin e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2016.

Neni 2

Qëllimi, sipas nenin 1 të këtij vendimi, është që me rishikimin e Buxhetit për vitin 2016, mjetet të ridestinohen në kategori buxhetore, sipas nevojave të Komunës dhe atë bëhet në shumën e përgjithshme prej 161,500,00€ dhe atë në:

Investime kapitale në shumë prej	138,500,00 euro
Subvencione në shumë prej	23,000,00 euro

Neni 3

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2016.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në Kuvend si dhe pas aprovimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe i njëjti shpallet në tabelën e shpalljeve dhe në faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr. 1752

Më datë 24.05.2016

